



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:211162

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06101343

P.nr.189/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit A.H. nga Mitrovica, me vendbanim në komunën e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.1136/24 e datës 17.07.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 28.08.2024, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurorja e Shtetit Albana Parduçi dhe i pandehuri A.H., më datë 28.08.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 29.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: A.H. nga i ati E., e ëma L., e gjinisë L., data e lindjes... në Mitrovicë, me vendbanim në Vushtrri, me numër personal ..., student në fakultetin juridik në Universitetin e Mitrovicës, punon në mobilierinë Albedi, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE Më datë 04.06.2024 rreth orës 17:50 minuta në Vushtrri – Bulevardin “Adem Jashari” saktësisht në banesën e përbashkët kati 6 banesa nr.6, me dashje përdorë forcën ndaj të dëmtuarit vëllait E.H. si pasojë e mosmarrëveshjes të atëçastshme lidhur me disa rroba – maica, ashtu që pasi që i pandehuri vëren se rrobat janë të njollosura niset në drejtim të dëmtuarit fillimisht duke bërëtitur pastaj e kap për fyti, i njëjti tenton që ta evitoj sulmin duke e shtyrë, por që i pandehuri prapë e kap për fyti dhe e godet me grusht në kokë me që rast ndërhyjnë nëna për t’i ndarë,

- Me këtë ka kryer veprën Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 184 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 462 të KPPK-së, e

G J Y K O N

Të pandehurit: A.H. i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej pesëqind euro (500€), i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsjetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr. 1136/24 e datës 17.07.2024, kundër të pandehurit A.H. nga Mitrovica, me vendbanim në Vushtrri, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së,

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 28.08.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, i pandehuri A.H. ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre, dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do e përsërisë më veprën.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se është pajtimit me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pranimi i fajësisë është i vullnetshëm i bazuar në provat materiale si në aktakuzë si dhe i propozon gjykatës që pranimin e fajësisë të e marr si rrethanë lehtësuese.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin

aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2024-BD-512, i datës 04.06.2024, raporti i oficerit, i datës 04.06.2024, procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin e.h., i datës 04.06.2024, procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin L.L, i datës 12.06.2024, procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin A.H., i datës 04.06.2024 dhe fotoalbumi në shtojcë prej dy fotografive si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 184 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Sulmi e kryen “*Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit*”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pajtimin me të dëmtuarin si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur faktin se kjo vepër penale është kryer brenda familjes dhe vetë ligji e parasheh si rrethanë rënduese.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë në shumë prej pesëqind euro (500€) euro, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi”*.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.189/2024, datë 29.08.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.